



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE**

**Nr. i Dokumentit: 24.4.1-2016-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT  
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË MINISTRISË SË  
ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË  
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

**Prishtinë, qershor 2017**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Luljeta Sylaj, Ariana Berisha-Rexhëbeqaj dhe Arnisa Aliu, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Bujar Bajraktari.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	6
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	15
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	29
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	30
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak .....	32
Shtojca IV: Letërkonfirmimi .....	39

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit<sup>1</sup>, të datës 20/10/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.


Megjithatë ne tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se vlera e pasurive fikse, e shpalosur në PFV ishte e mbivlerësuar. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos bartjes së pronësisë së shkollave të komunat dhe si pasojë e regjistrimit të librave në regjistrin e pasurive kapitale.

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Ministrin dhe stafin e tij për bashkëpunim e ofruar ndaj stafit tonë, gjatë procesit të auditimit.

<sup>1</sup> Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimit të Auditimit”

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore janë:****Përgjigja e Ministrit - auditimi 2016**

Ministri i ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet si dhe është zotuar se do t'i implementojë rekomandimet e dhëna.

---

# 1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të prezantuara në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesorë Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informatave në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar dhe për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.1 Opinioni i auditimit

### Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar Pasqyrat Financiare Vjetore e MASHT-it për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, PFV-të për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullores MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

### Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Pasuritë kapitale janë të mbivlerësuara për rreth 13 mil€. Kjo ka ndodhë për faktin që shkollat e ndërtuara nga MASHT, pas finalizimit nuk ishin transferuar te komunat që janë edhe pronarë të atyre shkollave; si dhe
- Ligji nr.04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës obligon MASHT-in që të ofrojë falas tekstet shkollore për nxënësit e nivelin I dhe II të arsimit parauniversitar. Bazuar në këtë, MASHT në vitin 2016 kishte buxhetuar dhe shpenzuar 9,259,452€<sup>2</sup>. Mjetet për këto tekste ishin trajtuar gabimisht si Investime Kapitale në vend se të trajtohen si Subvencione dhe Transfere, edhe përkundër kërkesave të MASHT-it drejtuar MF-së, që këto mjete të mos trajtohen si investime kapitale. Këto shpenzime ishin regjistruar në regjistrin e pasurive duke mbivlerësuar vlerën e pasurive të shpalosur në PFV.

Opinionin jonë nuk është modifikuar për këto çështje.

## Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i MASHT-it është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

---

<sup>2</sup> Në kuadër të kësaj shume hyjnë edhe obligimet nga viti i kaluar (për blerjen e teksteve shkollore) në vlerë prej 2,368,415€.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

MAShT kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar dhe me kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiarë nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Për njësitë vartëse të MAShT-it raportimet në bordet e tyre drejtuese dhe për Universitetet Publike, raportimi tek Këshillat Drejtuese të Universiteteve;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrolleve (MFK);
- Raportet tremujore duke përfshirë edhe Pasqyrat Nëntëmujore Financiare;
- Raportet e progresit për investimet kapitale me vlerë mbi 10,000€;
- Raportet për faturat e papaguara;
- Planin e prokurimit dhe raportin për kontratat e nënshkruara publike; etj

Draft PFV-të përbmbanin disa gabime, të cilat pas sugjerimeve tona ishin përmirësuar dhe pasqyrat finale ishin dorëzuar përsëri në Thesar.

Edhe pas këtyre përmirësimeve, PFV-të përbmbanin disa gabime sa i përket shpalosjes së pasurive. Këto gabime janë sqaruar më lartë tek theksimi i çështjes.



Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në MF, mund të konsiderohet e saktë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, MAShT ka arritur të dorëzojë me kohë raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore.

### 1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjen e sipërpërmendur të baza për opinion si theksim i çështjes, ne japim rekomandimin si në vijim:

**Rekomandimi 1** Ministri duhet të siguroj se është bërë një rishikim gjithëpërfshirës për t'i përcaktuar arsyet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike, për t'i shmangur gabimet në klasifikimin e shpenzimeve dhe të sigurojë evidentimin dhe vlerësimin e saktë të pasurive kapitale dhe jokapitale. Pronësia e shkollave të ndërtuara për komunat duhet të bartet tek këto të fundit dhe ato pasuri të hiqen nga regjistri i pasurive të ministrisë. Për çështjen e librave duhet të zhvillohet debat në nivel të qeverisë për të gjetur një formë të pranueshme të trajtimit të tyre.

---

## 2 Qeverisja

### Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MAShT që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga MAShT duhet të siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të ndikojnë në përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në kuadër të qeverisjes së mirë ne vlerësojmë përparimin e MAShT-it në hartimin e listës së rreziqeve, si një dokument fillestar. Megjithatë ekzistojnë disa dobësi të qeverisjes, veçanërisht në lidhje me moszbatimin e plotë të rekomandimeve nga viti paraprak, ka mungesë angazhimi në plotësimin e pozitive kyçe që mbahen me ushtrues detyre, (për më shumë se një vit) dhe ndikim të ulët të auditimit të brendshëm në rritjen e efikasitetit të kontrolleve të brendshme.

MAShT duhet të angazhohet në përmirësimin e mangësive të lartcekura në mënyrë që të parandalojë mundësinë që të ketë vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim joefektiv, i cili ndikon direkt në ofrimin e shërbimeve të dobëta për taksapaguesit.

## 2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e MAShT-it të vitit 2015 ka rezultuar në 26 rekomandime. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, shtatë (7) rekomandime janë zbatuar plotësisht; 15 janë në proces të zbatimit dhe katër (4) tjera nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

### Çështja 2 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioriteti i mesëm

<b>E gjetura</b>	MAShT ka bërë progres në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak. Megjithatë duhet të ndjeket një proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP), në mënyrë që ato të zbatohen plotësisht.
<b>Rreziku</b>	Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve në sistemet kyçe financiare, të cilat nuk janë adresuar, kanë ndikuar në: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpalosje jo të sakta dhe të plota të informatave në PFV;</li> <li>• Qeverisje jo të mirë, e cila redukton mundësinë që menaxhmenti të merr masa me kohë ndaj sfidave financiare; dhe</li> <li>• Mos adresimin e rekomandimeve të Auditimit të Brendshëm duke mos e përfillur në masën e duhur punën e tyre.</li> </ul>
<b>Rekomandimi 2</b>	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pazbatuara dhe atyre që janë në proces të zbatimit, me stafin përgjegjës të identifikuar, dhe duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Zbatimi i planit duhet të mbikëqyret në vazhdimësi.

## 2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të pyetësorit.

Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MAShT më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e MF në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

---

### Çështja 3 - Pyetësi i vet-vlerësimit - Prioritet i lartë

#### E gjetura

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë (5) komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Pyetësi i vet-vlerësimit i plotësuar nga MASHT ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut ishin në fazën fillestare. MASHT në prill 2017 kishte hartuar një listë të rreziqeve, ku për fushat operative kishte identifikuar rreziqet e mundshme dhe veprimet që duhet të ndërmerren, mirëpo nuk kishte hartuar ndonjë plan për monitorimin e zbatimit të planit për menaxhimin e rreziqeve;
2. Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit konsiderohen si të vendosura nga MASHT-i. Megjithatë për strategjinë 2011-2016, nuk kishte raport të monitorimit për vitin 2016;
3. Përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura nga MASHT dhe dëshmitë që na janë dhënë e mbështesin këtë konkluzion; dhe
4. Universitetet publike, të cilat funksionojnë në kuadër të MASHT-it, nuk e plotësojnë pyetësin e vet-vlerësimit, nuk kishin strategji zhvillimore (me përjashtim të Universitetit të Gjakovës), dhe nuk kishin plane vjetore të punës për vitin 2016 si dhe nuk kishin regjistër të rreziqeve.

#### Rreziku

Mungesa e menaxhimit efektiv të rreziqeve dhe monitorimit të strategjisë mund të ndikojnë në mos-arritjen e objektivave. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike. Poashtu mungesa strategjive dhe planeve të punës krijon paqartësi në lidhje me synimet e institucionit dhe e bën të pamundur monitorimin e arritjes së objektivave.

#### Rekomandimi 3

Ministri duhet të sigurojë se është rishikuar procesi i plotësimit të pyetësit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave të identifikuara me dobësi, në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. Poashtu Ministri duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një staf përkatës dhe të sigurojë monitorim të rregullt dhe raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë. Rektorët e universiteteve duhet të sigurojnë që strategjitë dhe planet e punës të hartohen, dhe arritja e objektivave dhe realizimi i planeve të monitorohet në baza të rregullta kohore.

## 2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar në planifikimin e auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit operon MASHT dhe sfidat me të cilat përballet.

### 2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Universitetet, agjencitë dhe njësitë e MASHT-it kanë autonomi të kufizuar veprimi. Këto nuk janë të pavarura në kontekstin e PFV-ve, e disa edhe në realizimin e shpenzimeve pasi që pagesat kalojnë përmes MASHT-it dhe kjo e fundit përgatit PFV-të finale. Po ashtu planifikimi i buxhetit bëhet nga MASHT-i në bashkëpunim me zyrtarët financiar të universiteteve, agjencive dhe njërive tjera. Për të siguruar një menaxhim financiar efektiv nevojitet një proces efektiv i konsolidimit dhe raportim me kohë.

#### Çështja 4 - Proceset e llogaridhënies - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Gjatë vitit 2016, në 17 raste pozitat menaxhuese (përfshirë Sekretarin e Përgjithshëm, drejtoret e departamenteve, udhëheqës të divizionit dhe pozita të zyrtarëve të ndryshëm) ishin mbuluar me Ushtrues Detyre (UD), për raste të caktuara me kohëzgjatje më shumë se një (1) vjet. Kjo dukuri është e shprehur edhe në agjencitë dhe programet tjera të MASHT. Kjo situatë ka rrjedhë si pasojë e mos përfundimit të proceseve gjyqësore dhe mospërfilljes së afatit për UD. Si rezultat funksionimi i strukturave qeverisëse nuk ka siguruar gjithmonë llogaridhënie efektive.
- Rreziku** Mbajtja e pozitave të larta me UD për kohë më të gjatë se sa është e lejuar, mund të rezultojë me llogaridhënie të dobët dhe funksionim jo efikas të kontrolleve menaxheriale.
- Rekomandimi 4** Ministri duhet të sigurojë që brenda një periudhe të arsyeshme kohore, pozitat me UD të plotësohen me staf të rregullt dhe mos të tejkalohet afati ligjor për ushtrimin e pozitës në cilësinë e UD-së. Kjo e rritë llogaridhënien, përgjegjësinë dhe siguron zhvillim efektiv të aktiviteteve të ministrisë.

## 2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB-së dhe një (1) auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe rreziqet tjera të Ministrisë dhe i cili ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

### Çështja 5 - Funkcionimi dhe efikasiteti i NjAB - Prioritet i lartë

<b>E gjetura</b>	<p>Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me NjAB, si;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• NjAB vazhdon të operojë me numër të kufizuar të stafit, krahasuar me madhësinë, kompleksitetin dhe nevojat e Ministrisë. Në planin vjetor të auditimit për vitin 2016 ishin planifikuar tetë (8) auditime. Prej tyre gjatë vitit ishin realizuar gjashtë (6) auditime, derisa në kuadër të auditimit të shkollave speciale/qendrave burimore janë bërë tri (3) raporte të auditimit pasi në auditim janë përfshirë tri (3) nga gjashtë (6) qendrat ekzistuese. Në bazë të kësaj i bie që janë bërë tetë (8) raporte të auditimit por kanë mbetur pa u mbuluar nga auditimi i brendshëm, fusha të rëndësishme si: prokurimi dhe qendra e studentëve;</li> <li>• Raportet e auditimit të brendshëm nuk ishin trajtuar seriozisht nga menaxhmenti. Në raportet e auditimit janë dhënë gjithsej 40 rekomandime, por nuk është monitoruar procesi i zbatimit të rekomandimeve të NjAB-së. Rrjedhimisht nuk ka informata të sakta se sa nga këto rekomandime janë zbatuar; dhe</li> <li>• Komiteti i Auditimit (KA) kishte mbajtur tri takime, mirëpo nuk kishte dhënë kontribut domethënës në përmirësimin e kontrolleve të brendshme, sepse asnjë veprim nuk është ndërmarrë nga ana e tij për të shtyrë përpara zbatimin e rekomandimeve të NjAB-së.</li> </ul>
<b>Rreziku</b>	<p>Mos zbatimi i rekomandimeve të NjAB-së ndikon që niveli i kontrolleve të brendshme të mos përmirësohet dhe rrit rrezikun që gabimet dhe mangësitë e njëjta të vazhdojnë të përsëriten, duke rezultuar në joefikasitet operativ dhe humbje financiare.</p>
<b>Rekomandimi 5</b>	<p>Ministri duhet të sigurojë se KA i rishikon në mënyrë kritike planet dhe raportet e auditimit duke siguruar një komunikim efektiv në mes menaxhmentit, KA-së dhe NjAB-së. Po ashtu, menaxhmenti duhet të ndërmerr veprime konkrete për ti zbatuar rekomandimet e NjAB-së. KA duhet të jetë më aktiv në shtyrjen e këtij procesi përpara dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve.</p>

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh kyçe në sistemet financiare, por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalohet rreziku që MASHT të ketë vlerë të dobët për paranë e shpenzuar dhe menaxhim jo efektiv të aktiviteteve. Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë: menaxhimi dhe monitorimi i kontratave, menaxhimi i pasurive jo-financiare dhe menaxhimi i detyrimeve.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,868,948	1,868,948	3,222,790	3,187,905	3,953,410

Të hyrat e planifikuara ishin 3,990,829€, derisa gjatë vitit 2016 ishin arkëtuar 3,222,790€. Krahasuar me vitin 2015 kishte rritje të të hyrave për 11%, por në krahasim me planin vjetor, realizimi ishte 81% e planit. Në mosrealizimin e planit të të hyrave ka ndikuar ndër të tjera edhe heqja e tarifës për pagesën e testit të maturës nga maturantët. Të hyrat e lejuara për shpenzim në këtë vit ishin 1,868,948€, derisa janë shpenzuar nga të hyrat aktuale 1,454,985€ pjesa tjetër e të hyrave shkon në Buxhetin e Kosovës.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>3</sup>	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>45,545,415</b>	<b>49,684,732</b>	<b>47,892,635</b>	<b>42,800,007</b>	<b>49,325,724</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	42,076,467	44,903,931	44,228,978	38,954,016	44,199,147
Financimi nga huamarrja	1,600,000	1,600,000	1,543,000	958,600	2,000,000
Të bartura nga viti paraprak <sup>4</sup>	-	512,772	507,121	397,468	294,080
Të hyrat vetjake <sup>5</sup>	1,868,948	1,868,948	946,897	1,282,535	1,938,389
Donacionet e jashtme	-	799,081	666,639	1,207,388	894,108

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 4,139,317€. Kjo rritje ka ndodhur si rezultat i rishikimit të buxhetit dhe vendimeve të mëvonshme Qeverisë për ndryshime buxhetore.

Në vitin 2016 MASHT ka përdorur 96% të buxhet final ose 47,892,635€, me një përmirësim prej 5% krahasuar me vitin 2015. Për realizimin e buxhetit më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>45,545,415</b>	<b>49,684,732</b>	<b>47,892,635</b>	<b>42,800,007</b>	<b>49,325,724</b>
Pagat dhe Mëditjet	14,939,774	16,054,402	15,925,257	13,314,071	8,641,673
Mallrat dhe Shërbimet	9,057,453	9,207,561	8,294,192	8,851,988	9,520,979
Shërbimet komunale	1,245,259	1,115,732	935,411	991,042	735,285
Subvencionet dhe Transferet	3,821,929	3,393,938	3,374,488	3,918,128	3,963,032
Investimet Kapitale	16,481,000	19,913,099	19,363,287	15,724,778	26,464,754

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje është rritur për 724,682€ në krahasim me buxhetin fillestar. Kjo ka ndodhur si rezultat i rishikimit të buxhetit, si dhe vendimeve të Qeverisë për përshtatjen e buxhetit të MASHT-it;
- Buxheti për mallra dhe shërbime, fillimisht ishte zvogëluar me rastin e rishikimit të buxhetit për 930,980€, derisa me vendime të mëvonshme të Qeverisë ishte rritur për 1,081,088€. Këtu përfshihet transferimi i shumës prej 213,300€ nga subvencionet në mallra dhe shërbime (për kompensimin e komisioneve të përfshira në vlerësimin e testit të maturës), si dhe nga të hyrat vetanake të bartura shuma prej 450,572€ dhe nga donacionet

<sup>3</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>4</sup> Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>5</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.



722,182€. Në fund kishte prapë zvogëlim të buxhetit me vendim të Qeverisë, në emër të kursimeve buxhetore në vlerë 404,956€;

- Buxheti final për shërbime komunale ishte zvogëluar për 138,526€ në krahasim me buxhetin fillestar. Kjo është bërë me rishikim të buxhetit dhe me vendime të Qeverisë;
- Buxheti për subvencione dhe transfereve fillimisht ishte rritur me rishikim të buxhetit për 207,130€, ndërsa më vonë me vendim të qeverisë është zvogëluar për 635,120€. Shpenzimet në këtë kategori ishin 99% e buxhetit final; dhe
- Buxheti për Investime Kapitale, me rishikim të buxhetit ishte zvogëluar për 1,526,327€ dhe më pas me vendime të qeverisë ky buxhet është rritur për 4,994,426€. Pjesa më e madhe e rritjes së buxhetit (3,149,524€) ishte bërë për mbulimin e shpenzimeve të blerjes së librave për nxënësit e klasave 1-9. Në fund realizimi i buxhetit të investimeve kapitale ishte 97% e buxhetit final.

## Çështja 6 – Planifikimi dhe realizimi i buxhetit – Prioriteti i lartë

**E gjetura** Edhe pse buxheti final është realizuar në masën 96%, nuk mund të themi se MASHT-i kishte performancë të mirë buxhetore. Kjo për shkak se gjatë vitit janë shfaqur nevoja të shumta për ri përshtatje të buxhetit dhe transfere në mes kategorive dhe programeve të ndryshme buxhetore.

Po ashtu koncentrimi i shpenzimeve ishte në pjesën e fundit të vitit, ku 46% e buxhetit total është shpenzuar në tremujorin e fundit të vitit. Një ndër arsyet e shpenzimeve në fund vit ishte blerja e librave që është realizuar pas shtatorit.

Një tjetër çështje e ndërlidhur me realizimin e buxhetit është keq-klasifikimi i shpenzimeve. Inventar dhe pajisje në vlerë prej 75,465€ ishin planifikuar/realizuar nga Investimet Kapitale, derisa është dashur të realizohen nga mallrat dhe shërbimet.

**Rreziku** Ndryshimet e shumta në buxhet përgjatë vitit rritin rrezikun që synime dhe objektiva të caktuara të mos realizohen sipas synimeve fillestare. Koncentrimi i shpenzimeve të shumta në muajt e fundit të vitit mund të ndikojnë që pagesat t’ju shmangen kontrolleve efektive si rezultat i shtimit të volumit të pagesave. Klasifikimi joadekuat i shpenzimeve shkakton mbivlerësim/nënvlerësim të kategorive të caktuara ekonomike në PFV.

**Rekomandimi 6** Ministri duhet të sigurojë që planifikimit të kërkesave buxhetore t’i paraprijë një analizë e mirëfilltë e nevojave si dhe faktorëve që ndikojnë në realizimin e buxhetit. Kjo do të zvogëlonte nevojat për përshtatje të buxhetit përgjatë vitit. Poashtu performanca buxhetore duhet të monitorohet në mënyrë sistematike në baza mujore, të identifikohen dhe adresohen barrierat në realizimin e planifikuar të buxhetit. Klasifikimi i shpenzimeve duhet të bëhet në pajtim me planin kontabël.

## Çështja 7 - Pagesa e Avancit në kundërshtim me ligjin e buxhetit - Prioritet i lartë

- E gjetura** Sipas ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, në muajin nëntor nuk do të ketë pagesa të paradhënies mbi dhjetë (10%) dhe në dhjetor mbi pesë (5%) të vlerës së kontratës dhe atë, vetëm pas aprovimit nga Ministri i Financave. Ne kemi gjetur se për projektin e shkollës fillore në Klinë, është dhënë avanc në muajin dhjetor në vlerë 108,671€ (10% e vlerës së kontratës). Për pagesën e avancit nuk ishte marrë aprovimi i nevojshëm paraprakisht.
- Rreziku** Pagesat e avanceve pa aprovimet e duhura është në kundërshtim me buxhetin dhe bart me vete rrezikun që të ndodhin pagesa jashtë kontrolleve të duhura në njërën anë, dhe shmangie nga suficiti buxhetor.
- Rekomandimi 7** Ministri duhet të iniciojë një rishikim specifik për të përcaktuar arsyet e pagesës së avancit në kundërshtim me ligjin e buxhetit, dhe të përcaktojë masat e nevojshme që sigurojnë që nuk do të ndodhin pagesa të tilla në të ardhmen. Të gjitha pagesat në avancë, duhet të bëhen në harmoni me Ligjin e buxhetit, dhe kërkesat e rregullave financiare.

### 3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga MASHT gjatë vitit 2016 ishin 3,222,790€ €. Nga 1,868,948€ sa ishin lejuar për shpenzim, MASHT gjatë vitit kishte shpenzuar 1,454,985€. Pjesa tjetër janë bartur në buxhetin e përgjithshëm të Kosovës. Të hyrat mbliidhen nga participimet e studentëve për banim dhe ushqim në Qendrën e Studentëve (QS), participimi për shërbimet akademike, licencat për institucionet arsimore, shitja e shërbimeve, qiraja si dhe nga taksat për verifikimin e dokumenteve.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet përbëjnë 32% të shpenzimeve të MASHT-it. Ato paguhen përmes një sistemi të centralizuar qeveritar (payroll). Megjithatë shumë kontrolle kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave e që kanë të bëjnë me: autorizimin e listës së pagave, verifikimin e ndryshimeve, llogaritjen e shtesave dhe honorarëve për profesorët, rishikimin e buxhetit etj, duhet të zbatohen në nivel të ministrisë dhe njësisive. Këto kontrolle sa i përket pagave të profesorëve janë të deleguara në nivel të fakulteteve dhe në departamentin e financave në AQ. Kompensimi i pagave dhe mëditjeve përveç legjislacionit tjetër në sektorin publik, rregullohet edhe me rregulloret e brendshme të Universiteteve për të ardhurat personale. Testimet tona kanë vënë në pah se tek kontrollet në fushën e pagave nuk ishin çdo herë efektive për të parandaluar gabimet dhe pagesat jo të rregullta. Në veçanti ne kemi identifikuar:

---

## Çështja 8 - Menaxhimi i pagave për profesorët - Prioritet i lartë

### E gjetura

Të gjitha universitetet publike të cilat funksionojnë në kuadër të MASHT-it, i kanë hartuar Rregulloret për të Ardhurat Personale të stafit derisa si model është marrë Rregullorja për të Ardhurat Personale e Universitetit të Prishtinës. Këto rregullore parashohin, mënyrën e kompensimit të personelit akademik, duke u bazuar në kushte dhe kritere të caktuara për stafin. Gjatë auditimit të pagave të stafit akademik, në gjashtë (6) Universitete<sup>6</sup>, ne kemi hasur në shumë raste ku rregulloret për të ardhurat personale nuk janë zbatuar. Kjo ka reflektuar në çështjet në vijim:

- Në katër raste në UPz dhe në një rast në UHZ nuk ishte mbajtur norma e plotë e orëve mbi normë, derisa kompensimi ndaj profesorëve ishte bërë i plotë. Rregullorja parasheh që kompensimi të mos bëhet në rast të mos plotësimit të normës;
- Në tre (3) raste në UMIB kemi parë se profesorët paguhen në avanc, (psh për orët mbinormë të muajit dhjetor, profesorët kompensohen po në muajin dhjetor, përderisa sipas rregullores për pagat, kompensimi duhet të bëhet në muajin pasues në bazë të dëshmimeve për mbajtjen e atyre orëve);
- Nga testimi i listave të vijueshmërisë në Universitete, kemi gjetur nëntë (9) raste në UPz, katër (4) raste në UKZ, ku listat e vijueshmërisë së studentëve në ligjëratë nuk vërtetohen nga personi i autorizuar i fakultetit. Mos vërtetimi i listave nga zyrtarët e autorizuar lë hapësirë për dyshim në mbajtjen e orëve nga mësimdhënësit. Duhet të theksohet që UPz, pas rekomandimit tonë, në tremujorin e fundit të vitit 2016, është angazhuar në përmirësimin e kësaj mangësie;
- Nga 52 mostrat e testuara në UPz dhe UHZ, në dy (2) raste në UHZ, dhe në gjashtë (2) raste në UPz kemi vërejtur se profesorët nuk shënojnë fare orën e mbajtjes së ligjëratës, e disa të tjerë shënojnë vetëm fillimin e orës së mbajtjes së ligjëratës, përderisa zyrtarët përgjegjës për kalkulimin e orëve të mbajtura e bëjnë kalkulimin pa ato dëshmi;
- Në dy (2) raste kemi vërejtur që profesorët nuk e kanë plotësuar në tërësi fondin e orëve të parapara për mësimdhënie, dhe të njëjtit janë kompensuar me pagë të plotë. Në një rast profesori kishte mbajtur vetëm katër (4) orë mësim më pak, dhe rasti tjetër profesori gjashtë (6) orë më pak mësim, derisa kanë marrë pagën e plotë. Sipas rregullores mos mbajtja e orëve penalizohet me heqje të pjesshme të pagës.

---

<sup>6</sup> Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" (UPz), Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani" (UGjFA), Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka" (UKZ), Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka" (UHZ), Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB), Universiteti i Shkencave të Aplikuara Ferizaj (UShAF).

---

---

**Rreziku** Kompensimi i profesorëve në kundërshtim me rregulloret rrit rrezikun e keqmenaxhimit me buxhetin dhe ekzekutimin e pagesave të parregullta. Po ashtu pagesat në avanc, mungesa e monitorimit dhe verifikimit të vijueshmërisë së procesit mësimor nga zyrtarët e autorizuar të fakultetit rrit rrezikun e kryerjes së pagesave për shërbimet potencialisht të pa pranuar.

**Rekomandimi 8** Ministri në bashkëpunim me rektorët e universiteteve duhet të sigurojnë që të gjitha pagesat/kompensimet të bëhen në pajtim të plotë me Rregulloret e të Ardhurave Personale. Duhet të forcohen kontrollet e monitorimit dhe verifikimit të vijueshmërisë së procesit mësimorë në mënyrë që pagesat të jenë të bazuara në shërbimet e ofruara, derisa për orët e pa mbajtura duhet të zbatohen ndalesat konform kërkesave të rregulloreve.

### Çështja 9 - Kompensimet e mësimdhënësve për provimet – Prioritet i mesëm

**E gjetura** Universitetet në kuadër të MASHT-it kanë adaptuar rregulloret e veta për të ardhurat personale, bazuar në rregulloren e Universiteti i Prishtinës Nr 1/126 e nxjerrë me 27/04/2012, sipas së cilave parashohin kompensimet e profesorëve për çdo student të nivelit bachelor që paraqitet në provim, në lartësinë prej 0.60€ dhe për çdo student të nivelit master që paraqitet në provim, në lartësinë 3€. Sipas udhëzimeve aktuale në fuqi, studentët e nivelit bachelor nuk paguajnë fare për paraqitje të provimit, dhe studentët në nivelin master për çdo provim të paraqitur paguajnë nga 2.5€. Kjo do të thotë se të hyrat e siguruara nga paraqitja e provimeve nuk i mbulojnë shpenzimet për kompensimin e profesorëve. Përveç kësaj, mbajtja e provimeve do të duhej të jetë pjesë e pandashme e detyrave të punës për të cilën profesorët e marrin pagën bazë dhe eventualisht honorarët.

**Rreziku** Kompensimi i profesorëve për provime, shkakton kosto të panevojshme për universitetet dhe mund të sjell vështirësi financiare. Kjo mund të dëshmohet edhe me gjendjen e vazhdueshme të obligimeve dhe kërkesave për mjete shtesë tek pagat.

**Rekomandimi 9** Ministri së bashku me Rektorët e universiteteve, duhet të shikojnë mundësitë rreth rishikimit të rregulloreve të lartcekura, në mënyrë që ajo të përshtatet me rrethanat aktuale dhe me mundësitë buxhetore. Po ashtu për shkak të natyrës së njëjte të punës, ministri duhet të angazhohet në unifikimin e rregulloreve dhe kompensimeve.

---

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 9,207,561€. Prej tyre ishin shpenzuar 8,294,192€ apo rreth 90%. Këto shpenzime kanë të bëjnë me shërbime kontraktuese, furnizime me material harxhues, shërbime, mirëmbajtje etj.

---

#### Çështja 10 – Vazhdimi i kontratave kornizë - Prioritet i lartë

**E gjetura** Sipas rregullave të prokurimit publik, kontrata publike kornizë nuk mund të zgjatet apo ripërtërihet, që nënkupton se kohëzgjatja e kontratës duhet të përcaktohet në fillim të procesit të prokurimit. QS kishte lidhur dy kontrata kornizë 24 muajshe: “Furnizim me mish dhe produkte të mishit për nevoja të menzës së QS” në vlerë 743,000€, e cila kishte përfunduar me 15.07.2015, dhe “Furnizim me artikuj tjerë ushqimor për nevoja të menzës së QS” me vlerë 426,036€ e cila kishte përfunduar me 17.07.2015. Pas skadimit të kontratave, të dyja janë vazhduar edhe për periudhën një vjeçare. Arsyetimi ishte nevoja e domosdoshme për furnizim në QS dhe pritja që ky furnizim të realizohet përmes AQP.

**Rreziku** Çdo devijim nga korniza ligjore mund të shfaq rrezikun e jo transparencës së shpenzimit të parasë publike dhe transaksioneve potencialisht të dëmshme për MASHT-in, respektivisht QS.

**Rekomandimi 10** Ministri duhet të sigurojë që janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për evitim të rasteve të tilla, dhe të përcaktohen alternativa më të përshtatshme për të menaxhuar situatat e ngjashme.

### 3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 3,393,938€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 3,374,488€, apo 99% e tyre. Ky buxhet është shfrytëzuar për kategori të ndryshme të arsimit, pjesa më e madhe për mbështetje të skemave të ndryshme të bursave me partnerë të jashtëm dhe një pjesë për projekte hulumtuese dhe shkencore.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.1.5 Investimet kapitale

Investimet kapitale konsumojnë pjesën më të madhe të buxhetit të MASHT apo rreth 40% të tij. Buxheti final për këtë kategori ishte 19,913,099€, nga të cilat ishin shpenzuar 97% apo 19,363,287€. Ky buxhet ishte shpenzuar për rregullimin dhe ndërtimin e objekteve arsimore dhe administrative, blerjen e librave, blerjen e pajisjeve të teknologjisë informative, blerjen e inventarit etj. Testimet tona kanë venë në pah mangësitë në vijim:

#### Çështja 11 - Menaxhimi i projekteve kapitale - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Sipas rregullores për prokurimin publik dhe praktikave të mira, kurdo që menaxhimi i kontratës kërkon ekspertizë, një gjë e tillë duhet të bëhet, në mënyrë që ndërtimet të bëhen sipas kushteve dhe cilësisë së duhur. Në rastet e realizimit të punëve ndërtimore që kanë të bëjnë me ndërtimin e objekteve arsimore, për shtatë (7) kontratat e testuara, MASHT kishte caktuar menaxheret e kontratave të cilët kanë përcjellë realizimin e punimeve, mirëpo nuk kishte caktuar edhe organin mbikëqyrës profesional i cili njëkohësisht bënë përcjelljen e investimeve kapitale dhe mbikëqyrë punët specifike të parapara në kontratë.

**Rreziku** Menaxhimi i kontratave të ndërtimit, në mungesë të organit mbikëqyrës rrit rrezikun që kontratat të mos realizohen sipas sasisë dhe kualitetit të paraparë në kontratat e lidhura.

**Rekomandimi 11** Ministri duhet të kërkojë nga departamenti i mbikëqyrjes së projekteve që në rastet e realizimit të punëve ndërtimore, të propozohen dhe caktohet organet mbikëqyrëse profesionale për të siguruar që ndërtimet realizohen sipas standardeve të përcaktuara në kushtet e kontratave respektive.

#### Çështja 12 - Vonesa në realizimin e projekteve kapitale - Prioritet i lartë

**E gjetura** Procesi i ndërtimit të shkollave është përcjellë me vonesa shumëvjeçare. Nga 11 projektet e filluara në vitin 2009, gjashtë (6) prej tyre janë përfunduar, dy (2) ishin në proces të pranimit teknik, derisa në tri (3) të tjera<sup>7</sup> ende vazhdojnë punimet. MASHT nuk kishte aplikuar penale ndaj kompanive, ngase sipas tyre rrethanat e vonesave kanë qenë të dyanshme, mungesa e buxhetit, ndryshimet në specifika dhe neglizhenca e kompanive nga ana tjetër.

**Rreziku** Vonesat në përfundimin e projekteve reflektojnë në cilësinë e punimeve. Kjo poashtu ndikon në mos arritjen e objektivave të Ministrisë dhe në cilësinë e shërbimeve të ofruara.

**Rekomandimi 12** Ministri duhet të sigurojë një shqyrtim detal të arsyeve që kanë shkaktuar vonesat në realizimin e këtyre projekteve dhe të ndërmerr masat e nevojshme në mënyrë që ato të përfundohen sa më parë. Cilësia e punimeve duhet të verifikohet nga organet kompetente për mbikëqyrje, për të konfirmuar se punët janë kryer në pajtim me kushtet dhe standardet e kontraktuara.

<sup>7</sup> Ndërtimi i shkollës fillore në Fushë Kosovë, dhe shkollat e mesme në Podujevë dhe Mitrovicë

---

### 3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë paraqitur çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale.

---

#### Çështja 13 – Menaxhimi i kontratave - Prioritet i lartë

**E gjetura** Udhëzimi për Prokurimin Publik përcakton që pas nënshkrimit të kontratës duhet të caktohet një menaxher i kontratës dhe duhet të bëhet një plan për menaxhimin e kontratës, përmes të cilit do të monitorohet ecuria e kontratës. Megjithatë kjo kërkesë nuk ishte zbatuar plotësisht nga njësitë e MAShT duke rezultuar me mangësi në menaxhimin e kontratave në rastet e mëposhtme:

- Tek projekti “Hartimi i planeve kryesore për UHZ” me vlerë 143,525€, e cila ishte bërë në marrëveshje me Komunën e Pejës, nuk kishte plan për menaxhimin e kontratës. Përveç kësaj raporti i pranimit nuk përmban detajet e nevojshme për të kuptuar se kompania ka përfunduar aktivitetet sipas specifikave të kërkuara në dosjen e tenderit;
- Për projektin “Renovimi i objektit dhe përshtatja e hapësirës për Gjykatore” në UHZ 18,462€, edhe pse ishte emëruar menaxheri i kontratës, nuk ishte hartuar plan për menaxhimin e kontratës. Poashtu komisioni i pranimit teknik kishte bërë disa vërejtje në punët e kryera, derisa në lëndën e pagesës nuk kishte dëshmi që dokumentojnë se ato vërejtje janë korrigjuar para se të bëhet pagesa;
- Në dy (2) raste, në QS nuk ishin emëruar fare menaxherët e kontratës, dhe në gjashtë (6) raste tjera - tre (3) në UHZ dhe katër (4) në UPz, menaxherët ishin caktuar formalisht por nuk ishin bërë planet për menaxhimin e kontratave.

**Rreziku** Mungesa e menaxherëve dhe planeve për menaxhimin e kontratave rrit rrezikun që kontratat të mos realizohen në përputhje me kushtet dhe specifikat e kontraktuara.

**Rekomandimi 13** Ministri duhet të kërkojë nga personat përgjegjës në Universitetet publike që për secilën kontratë të caktohen menaxherët e projekteve. Duhet të përgatiten planet për menaxhimin e secilës kontratë, dhe të bëhen raporte në lidhje me realizimin e kontratave.

---

**Çështja 14 - Planifikim jo i mirë i prokurimit - Prioritet mesëm**

- E gjetura** MASHT nuk kishte bërë një planifikim të mirë të prokurimit, kjo vërtetohet nga raportet e kontratave të nënshkruara nga të gjitha njësitë e saj, ku pjesa më e madhe e procedurave të prokurimit janë iniciuar dhe realizuar në pjesën e dytë të vitit. Derisa UPz nuk kishte përgatitur planin përfundimtar të prokurimit sipas kërkesave të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili kërkon që të identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që synon t'i prokurojë gjatë vitit.
- Rreziku** Planifikimi i dobët i prokurimit ndikon në vlerën e dobët për para dhe humbje potenciale financiare, si rezultat i mos identifikimit të nevojave të përbashkëta të njësive dhe mos aplikimit të procedurave adekuate të prokurimit.
- Rekomandimi 14** Ministri duhet të kërkojë nga zyrtarët e prokurimit që me rastin e hartimit të planit të prokurimit, në bashkëpunim me njësitë kërkuese të bëjnë një vlerësim të mirëfilltë të nevojave, dhe në planet e prokurimit ta përfshijnë edhe kohën e përafërt të realizimit të prokurimeve.

**Çështja 15 - Parregullsi në procedimin e pagesave - Prioritet i mesëm**

- E gjetura** Sipas Rregullës nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parasë Publike, fillimisht duhet të procesohet zotimi i mjeteve, të lëshohet urdhërblerja, dhe pas pranimit të blerjeve bëhet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura.
- Në procedimin e 17 pagesave të ndërlidhura me mallrat dhe shërbimet me vlerë 425,722€, ne kemi gjetur se fillimisht ishin pranuar mallrat/shërbimet dhe fatura, ndërkaq më vonë ishte bërë (zotimi i mjeteve, kërkesa për blerje, dhe urdhërblerja). Po ashtu te tetë (8) pagesa të investimeve kapitale me vlerë 526,249€, zotimi ishte bërë pas faturimit.
- Rreziku** Mos ndjekja e procedurave të duhura të kontrollit gjatë pranimit të mallit dhe kryerjes së pagesave mund të ndikojë në pranimin e mallrave që nuk janë në pajtim me kushtet e kontraktuara dhe pagesa potencialisht të parregullta.
- Rekomandimi 15** Ministri duhet të iniciojë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e rregullës financiare nuk janë adresuar në të gjitha rastet, dhe të përcaktojë masat/proceset e duhura për të siguruar që dështimet e ngjashme nuk do të ndodhin në të ardhmen.



---

**Çështja 16 - Mbyllja e avanceve - Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Në dy (2) raste në vlerë prej 15,198€, avanset nuk ishin mbyllur dhe arsyetuar brenda afatit ligjor. Vonesat ishin 30 dhe 58 ditë. Kjo është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ nr.2004/07 për udhëtimet zyrtare, derisa ka ndodhur për shkak se zyrtarët nuk i kanë sjell dëshmitë lidhur me shpenzimet e realizuara.

**E gjetura** Vonesat në mbylljen e avanceve rrisin rrezikun që paraja publike të përdoret në mënyrë të parregullt nga persona të caktuar.

**Rekomandimi 16** Ministri duhet të siguroj se kontrollat lidhur me menaxhimin e avanceve janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Të gjithë personat që shfrytëzojnë avance, të bëjnë barazimet e duhura brenda periudhës së kërkuar ligjore.

**Çështja 17 - Pranim jo i rregullt i mallrave - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Mënyra e pranimit të mallrave është e precizuar me Rregulloren Financiare nr. 01/2013. Mirëpo kjo rregullore nuk kishte gjetur zbatim efektiv nga njësitë e MASHT-it, duke rezultuar me mangësitë në vijim:

- Pranim jo të rregullt të inventarit për salla të sportit në shkollat e arsimit parauniversitar në vlerë 500,529€. Inventari ishte shpërndarë direkt në shkolla dhe pranimi ishte bërë nga drejtorët e shkollave, dhe në disa raste nga komisioni prej dy (2) anëtarëve;
- Te pagesa për furnizim me mjete të punës (material teknik, elektrik, për ngrohje qendrore dhe ujësjellës) për mirëmbajtje në QS në vlerë 7,467€, pranimi i materialit ishte bërë vetëm nga zyrtarja e pranimit, pa formuar ndonjë komision për pranimin e mallit;
- Tek pagesa “Blerja e pajisjeve nga projekti Euforia” në vlerë prej 159,020€ UHZ nuk kishte formuar komision për pranimin e mallit. Pranimi i pajisjeve ishte bërë nga një person si dhe nuk kishte raport të pranimit lidhur me sasinë dhe cilësinë e blerjeve që ishin pranuar; dhe
- Tek furnizimi me mobilje në UHZ në vlerë 8,370€ pranimi i mallit ishte bërë nga një komision prej tre zyrtarëve, mirëpo në lëndë nuk kishte ndonjë vendim/autorizim që dëshmon caktimin e këtij komisioni.

**Rreziku** Pranimi i inventarit nga persona jo kompetent dhe në mungesë të komisioneve të pranimit rrit rrezikun që të pranohen mallra të cilësisë jo të mirë dhe në kundërshtim me kushtet e kontraktuara.

**Rekomandimi 17** Ministri duhet të kërkojë nga zyrtarët përgjegjës të ministrisë dhe njësite vartëse që t'i respektojnë në mënyrë efektive dhe me konsistencë kërkesat e udhëzimeve në lidhje me pranimin e mallrave. Kjo do të siguronte që mallrat e pranuar, të përputhen në aspektin e cilësisë dhe sasisë, me mallrat e kontraktuar.

## 3.2 Pasuritë

### 3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera totale e pasurive të shpalosura në PFV-të e vitit 2016, ishte 263,109,320€. Prej tyre, pasuri kapitale (mbi 1,000€) ishin 259,777,730€, dhe pasuri jo-kapitale (nën 1,000€) ishin 3,331,590€. Poashtu në PFV janë shpalosur edhe stoqet në vlerë 715,270€. Pasuritë kapitale mbi 1000€ regjistrohen në regjistrin kontabël, derisa pasuritë nën 1000€ dhe stoqet i regjistrohen secila njësi në sistemin e-pasuria, të cilat më pas konsolidohen në një regjistër i cili prezantohet në PFV. Ne kemi identifikuar çështjet në vijim:

#### Çështja 18 - Paqartësi në bazën ligjore për blerjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore - Prioritet i lartë

**E gjetura** Bazuar në Ligjin nr.04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, MASHT ka nxjerr Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 13/2016 Pajisja e Nxënësve me Tekste Shkollore, Përdorimi dhe Ruajtja e Tyre, i cili udhëzim bie ndesh me Ligjin në fjalë, Ky Udhëzim i obligon nxënësit/prindërit që t'i ruajnë dhe t'i kthejnë tekset në fund të vitit shkolror, derisa Ligji potencon që tekset jepen falas. Edhe brenda vet ligjit ka kundërthënie ngase në njërin anë precizon që tekset jepen falas dhe në anën tjetër e obligon MASHT-in që të nxjerrë Udhëzim të veçantë për shpërndarjen dhe ruajtjen e tyre.

**Rreziku** Paqartësitë ligjore rreth procesit të furnizimit me tekste shkollore shkaktojnë konfuzion tek nxënësit/prindërit në lidhje me obligimin për t'i ruajtur apo kthyer tekset. Njëkohësisht kjo e vështirëson edhe menaxhimin e procesit të furnizimit dhe shpërndarjes së teksteve shkollore.

**Rekomandimi 18** Ministri duhet të inicioj rishikimin e Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe, me qëllim të shmangies së paqartësive rreth furnizimit dhe trajtimit të teksteve shkollore. Gjithashtu duhet të rishikohet Udhëzimi Administrativ (MASHT) nr. 13/2016, me qëllim të thjeshtimit dhe qartësimin të procesit.

**Çështja 19 - Mos deklarimi i stoqeve nga Drejtoritë Komunale të Arsimit - Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Komisioni për verifikim dhe shpërndarjen e teksteve i krijuar me datë 07/07/2016, kishte kërkuar nga Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) që të deklarojnë tekstet shkollore të deponuara (të pa shfrytëzuara) si dhe kërkesat e reja për vitin shkollor 2016/2017. Ne kemi vërejtur se me rastin e paraqitjes së kërkesave për furnizim me tekste shkollore, DKA në Drenas, Malishevë, Prizren, Rahovec, Ferizaj dhe Viti, nuk i kishin deklaruar fare stoqet.

**Rreziku** Mos deklarimi i stoqeve, mund të ndikoj në rritjen e kërkesave për tekste shkollore në krahasim me nevojat reale, dhe në rritje të panevojshme të shpenzimeve.

**Rekomandimi 19** Ministri duhet të sigurojë se është përmirësuar komunikim në mes të DKA-ve dhe komisionit përgjegjës për menaxhimin e shpërndarjes së teksteve shkollore, në mënyrë që kërkesat për tekste të jenë në pajtim me kërkesat.

**Çështja 20 - Menaxhimi i dobët i regjistrave të pasurive - Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Përveç çështjeve të paraqitura tek theksimi i çështjes, ne kemi identifikuar edhe çështje tjera që ndërlidhen me regjistrat e pasurive, të cilat për shkak të rëndësisë më të vogël nuk janë paraqitur tek theksimi i çështjes. Rregullorja nr. 02/2013 përcakton që pasuritë kapitale duhet të regjistrohen në SIMFK ndërsa pasuritë jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e - Pasuria”. Kjo rregullore nuk ishte zbatuar nga njësitë e MAShT duke rezultuar me mangësitë në vijim:

- Regjistri i pasurive kapitale tek UHZ ishte mbivlerësuar për 55,149€. Kjo shumë ka të bëjë me inventarin, blerja e të cilit gabimisht ishte realizuar nga Investimet kapitale, edhe pse vlera e tyre ishte nën 1,000€. Këto blerje është dashur të realizohet nga mallrat dhe shërbimet dhe të regjistrohet në e-pasuria;
- Gjithashtu vlera prej 143,728€ e paguar për hartimin e projekteve në UHZ, ishte regjistruar si pasuri në përdorim, derisa objektet për cilat janë hartuar këto projekte nuk kanë filluar ende së ndërtuari; dhe
- Agjencia për Arsim Profesional, Agjencia e Akreditimit, Instituti Pedagogjik, Qendra e Studentëve, Instituti Albanologjik, Universiteti i Mitrovicës, Universiteti i Gjilanit dhe Universiteti i Ferizajt, nuk e kanë përdorur sistemin e-pasuria për regjistrimin e pasurive jo-kapitale dhe stoqeve. Stafi nuk ishte trajnuar për të marrë qasjen për përdorimin e tij, prandaj pasuritë me vlerë nën 1,000€ ishin evidentuar në regjistra individuale të secilës njësi. Për më tepër për pasuritë nën 1,000€ në njësitë e lartpërmendura nuk është kalkuluar fare zhvlerësimi dhe si rrjedhojë e kësaj vlera e paraqitur në PVF është mbivlerësuar.

- Rreziku** Mos mbajtja e rregullt e regjistrave të pasurisë dhe mospërdorimi i sistemit e-pasuria, pamundëson menaxhimin efektiv dhe kontrollin e duhur mbi pasuritë. Kjo poashtu shkakton shpalosje jo të saktë të informatave në PFV.
- Rekomandimi 20** Ministri duhet të sigurojë që menaxhimi i pasurisë jo financiare i organizatës të bëhet konform udhëzimeve dhe rregullave në fuqi. Duhet të merren masat e duhura në drejtim të trajnimit të stafit dhe funksionalizimit të sistemit e-pasuria në të gjitha njësitë. Regjistrat e pasurisë duhet të jenë të plota, siç përcaktohet me udhëzuesin përkatës si dhe të azhurnohen në vazhdimësi me qëllim të paraqitjes së gjendjes reale të pasurisë në pasqyra financiare.

### 3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 593,760€. Kjo paraqet një progres domethënës në raport me vitin e kaluar duke marrë parasysh se në fund të vitit 2015 MASHT kishte obligime në vlerë prej 3,961,840€. Detyrimet e vitit 2016 janë bartur për t'u paguar në vitin 2017.

#### Çështja 21 – Menaxhimi i obligimeve - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Vlera e obligimeve të papaguara në fund të vitit 2016 ishte 593,760€. Kjo paraqet një pjesë të sfidës buxhetore ngase ministria kishte edhe detyrime kontingjente në vlerë 726,530€. Përderisa detyrimet kishin pësuar zvogëlim të konsiderueshëm, detyrimet kontingjente ishin rritur për rreth 11%. Rritja e detyrimeve kontingjente mund të afektojë buxhetin i cili është planifikuar të shpenzohet për projekte tjera.
- Rreziku** Mbetja e obligimeve të papaguara dhe rritja e obligimeve kontingjente, shton rrezikun që planet e ardhshme të shpenzimeve të mos arrihen për shkak të nevojës për t'i paguar obligimet paraprake apo detyrimet kontingjente.
- Rekomandimi 21** Ministri duhet të iniciojë një rishikim të gjendjes së detyrimeve të papaguara, për të përcaktuar shkaqet e vonesave dhe masat e nevojshme për evitimin e tyre. Po ashtu menaxhmenti duhet të trajtoj me kujdes të shtuar edhe trendin në rritje të detyrimeve kontingjente.

---

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

---

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

---

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

---

## Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponentët e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pazbatuara
Pasqyrat Financiare	Ministri duhet të analizojë arsyet për Theksimin e Çështjes në 2015 dhe ti identifikojë veprimet që kërkohen për të mundësuar klasifikimin e duhur të shpenzimeve dhe prezantimin e drejtë të pasurive në PVF-të e vitit 2016.			Nuk janë marrë masa.
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që të zbatohet një çasje më serioze në trajtimin e rekomandimeve të AP nga menaxhmenti. Duhet siguruar se është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë masat e ndërmarra, afatet kohore për implementim e rekomandimeve, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Planin e veprimit duhet të monitorohet formalisht në baza të rregullta dhe rezultatet duhet të raportohen tek menaxhmenti për të ndërmarrë masat adekuate.		Pjesa më e madhe e rekomandimeve janë në proces të zbatimit. Mbetet sfida edhe më tutje zbatimi i plotë i të gjitha rekomandimeve të dhëna.	
2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së	Ministri duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim i procesit të plotësimit të listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		Është zbatuar, pjesërisht. Lista e rreziqeve është hartuar në vitin 2017.	
2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes	Ministri duhet që të analizojë arsyet përse pozitat kyçe nuk janë plotësuar me kohë me staf të rregullt. Më tutje ministri duhet të priorizojë rekrutimin e stafit të rregullt në të gjitha pozitat që mbahen nga ushtrues detyre. Kjo rritë llogaridhënien, përgjegjësinë dhe siguron zhvillim efektiv të aktiviteteve të ministrisë.			Nuk janë marrë masa.



	Ministri duhet të siguroj që bashkërisht me stafin tjetër kyç të Ministrisë dhe rektorët, të hartojë një plan veprimi për masat e nevojshme për funksionalizimin e plotë të universiteteve publike. Gjithashtu ministri duhet të siguroj që është bërë një analizë kritike për të nxjerrë në pah vështirësitë dhe sfidat kryesore me të cilat mund të ballafaqohen universitetet gjatë procesit të pavarësimit funksional dhe organizativ, në mënyrë që ato të adresohen në mënyrën e duhur.		Rekomandimi është në proces të zbatimit.	
2.5.2 Menaxhimi i rrezikut	Ministri duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një staf/drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.		Lista e rreziqeve është krijuar në vitin 2017, mbetet në të ardhmen të vlerësohet monitorimi.	
2.5.3 Raportimi Menaxherial	Ministri së bashku me rektorin e Universitetit të Gjilanit, duhet të sigurojnë se është kryer një rishikim i kërkesave aktuale për raportim ndaj menaxhmentit, për të përcaktuar formën më të përshtatshme të raportimit, që do të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë. Rektori duhet të inicojë një kërkesë për çasje dhe trajnim të vazhdueshëm të stafit për të mbështetur menaxhmentin me raportim financiar. Njëkohësisht këshilli Drejtues, duhet të siguroj që raportet periodike financiare do të shqyrtohen dhe variancat eventuale ndërmjet buxhetit dhe shpenzimeve të trajtohen. Veprimet e nevojshme duhet të ndërmerren për të adresuar çështjet e ngritura.	Po.		

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Për të arritur përfitimin maksimal nga auditimi i brendshëm, Ministri duhet të sigurojë funksionimin e Komitetit të Auditimit dhe maksimizimin e punës së Auditimit. Komiteti duhet të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm (për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit) dhe rezultatet e auditimit të brendshëm. Gjithashtu duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.		Komiteti i auditimit është krijuar, megjithëse nuk ka dhënë kontribut domethënës.	
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Ministri duhet të siguroj një proces gjithëpërfshirës të buxhetimit që bazohet në komunikim dhe koordinim të plotë me stafin e universiteteve. Duhet të krijohen mekanizma që sigurojnë përfshirjen e gjithë stafit në procesin e buxhetimit. Përveç kësaj, sekretari i përgjithshëm duhet të iniciojë zhvillimin e një metodologjie (formule buxhetore) të pranueshme për ndarjen e buxhetit bazuar në kritere të përcaktuara.		Në proces të zbatimit.	
	Ministri duhet të sigurojë që performanca buxhetore të monitorohet në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim t'i identifikojë dhe adresojë barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në procesin e rishikimit të buxhetit.		Në proces të zbatimit.	
3.4 Prokurimi	Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim i brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha prokurimet e zhvilluara. Rrjedhimisht, duhet të vendosen kontrole të shtuara për të siguruar se dobësitë e identifikuar janë adresuar. Një plan konkret për përfundimin e punëve të mbetura në shkollat e pa përfunduara duhet të hartohet dhe i njëjti të monitorohet në baza të rregullta. Nevojat e prokurimit të hartuara nga njësitë duhet të inkorporohen në një plan të përbashkët për të lehtësuar menaxhimin e prokurimeve të parapara.		Krahasuar me vitin e kaluar ka çështje që nuk janë përsëritur më. Derisa sa i përket investimeve kapitale ende ka ngecje.	

3.4.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të sigurojë që është ndërmarrë një rishikim i menaxhimit të personelit, për të siguruar se ndryshimet e nevojshme raportohen me kohë për të parandaluar mbi pagesat eventuale. Arsyet për mos funksionimin e ndalesave me kohë duhet të analizohen dhe veprimet korrigjuese duhet të ndërmerren. Duhet të sigurohet një koordinim më të mirë ndërmjet departamenteve për të evituar gabimet e mundshme në paga dhe mëditje.	Po.		
3.4.2 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të iniciojë hartimin e një kornize ligjore, politike apo udhëzimi të brendshëm që rregullon fushën e subvencioneve. Baza ligjore duhet të përcaktoj prioritetet e ministrisë, kriteret dhe procedurat e nevojshme që duhet ndjekur përfituesit e mundshëm. Kjo do të orientonte subvencionet në fushat me më shumë interes për ministrinë, do të siguronte kontrole formale më të mira dhe do të ndikonte në rritjen e transparencës dhe mundësive të barabarta për të gjithë palët e interesuara.	Po.		
3.4.2 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të siguroj që subvencionet të jenë subjekt i monitorimit efektiv duke përcaktuar kërkesat për raportim ndaj përfitueseve të subvencioneve për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve.	Po.		
3.5 Të Hyrat vetjake	Ministri të kërkojë nga Kryeshefi i Agjencisë së Akreditimit që të konsideroj mundësinë e shtimit të modulit të të hyrave në Sistemin aktual të Menaxhimit të Informacionit. Kjo do të mundësonte një menaxhim më të mirë të të hyrave, përfshirë faturimin, raportimin dhe analizat e të hyrave të Agjencisë.		Agjencia e Akreditimit është në proces të digjitalizimit të proceseve në këtë institucion.	

3.6.2 Trajtimi i borxheve	Ministri duhet të iniciojë një rishikim të gjendjes së borxheve, për të përcaktuar shkaqet e vonesave dhe masat e nevojshme për adresimin e tyre. Vlerësimi i detyrimeve duhet të vazhdohet të bëhet në baza të rregullta mujore dhe pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare.		Krahasuar me vitin e kaluar, obligimet kanë rënë dukshëm, mirepo dhe me tutje detyrimet kontigjente janë të larta.	
Universitetet Publike 4.2 Qeverisja	Ministri duhet të siguroj se personat e ngarkuar me qeverisje nëpër universitete të vendosen pas një procesi rigoroz të vlerësimit në mënyrë që të garantohet një qëndrueshmëri e funksionimit të këshillave drejtues. Kjo mundëson një stabilitet më të lartë të qeverisjes për universitetet dhe arritje më të lehtë të objektivave strategjike.		Në proces të zbatimit.	
4.3 Kompensimi (Pagat dhe Mëditjet)	Rektori i Universitetit të Prizrenit duhet të bëj një analizë të të gjeturave të më sipërme dhe të shqyrtoj arsyet përse kërkesat e rregulloreve të brendshme për kompensim të stafit akademik nuk janë respektuar. Rektori duhet të siguroj që kontrollet zbatohen në nivel të fakulteteve dhe orët paguhen vetëm pasi të jetë konfirmuar edhe formalisht nga dekanët e fakulteteve se janë mbajtur evidencat e profesorëve.	Po		
	Rektori i Universitetit të Prizrenit së bashku me Sekretarin e Përgjithshëm duhet të bëjnë një zgjidhje të menjëhershme për stafin e auditimit brendshëm dhe stafin e zyrtarit të pasurisë. Rektori para çfarëdo rekrutimi duhet të siguroj një dialog të shtuar me ministrinë për të sqaruar përgjegjësitë dhe të drejtat me qëllim të shmangies së keqkuptimeve të legjislacionit.			Nuk janë marrë masa.

	Rektori i Universitetit të Pejës duhet të bëjë një analizë të të gjeturave të më sipërme dhe të shqyrtoj arsyet përse kërkesat e rregulloreve të brendshme për kompensim të stafit akademik nuk janë respektuar. Rektori duhet të sigurojë që kontrollet zbatohen në nivel të fakulteteve dhe orët paguhen vetëm pasi të jetë konfirmuar edhe formalisht nga dekanët e fakulteteve se janë mbajtur evidencat e profesorëve.		Akoma janë vërejtur mangësi edhe pse në raport me vitin paraprak numri i tyre ishte me i vogël.	
	Rektori i Universitetit të Pejës të rishikojë të gjitha kontratat për shërbime të veçanta dhe të përcaktoj arsyet dhe nevojën për një numër të lartë të kontratave të tilla. Një analizë gjithëpërfshirëse e nevojës për staf duhet të kryhet për të iniciuar një dialog me MASHT dhe Ministrinë e Financave për buxhet shtesë në paga dhe mëditje.		Akoma janë vërejtur mangësi edhe pse në raport me vitin paraprak numri i tyre ishte me i vogël.	
	Rektori i Universitetit të Gjakovës duhet të bëjë një analizë të të gjeturave dhe të shqyrtoj arsyet përse kërkesat e rregulloreve të brendshme për kompensim të stafit akademik nuk janë respektuar. Rektori duhet të sigurojë që kontrollet zbatohen në nivel të ulët të fakulteteve dhe orët paguhen vetëm pasi të jenë marrë të gjitha siguritë që ato janë mbajtur përfshirë evidencat e profesorëve dhe konfirmimet formale nga dekanët e fakulteteve.	Po		
	Rektori i Universitetit të Gjakovës duhet të sigurojë trajtimin e menjëhershëm të kësaj çështje dhe të ndërmarrë masat e nevojshme ligjore për të kthyer mjetet e paguara padrejtësisht, në buxhetin e Universitetit. Njëkohësisht duhet të sigurojë evitimin e rasteve të ngjashme në të ardhmen.		Rekomandimi është në proces. Organet kompetente janë duke u marrë me rastin.	

	Rektori i Universitetit të Mitrovicës duhet të bëj një analizë të të gjeturave të më sipërme dhe të shqyrtoj arsyet përse kërkesat e rregulloreve të brendshme për kompensim të stafit akademik nuk janë respektuar plotësisht. Rektori duhet të siguroj që kontrollet zbatohen në nivel të fakulteteve dhe orët paguhen vetëm pasi të jetë marrë siguria e nevojshme se orët janë mbajtur, përfshirë evidencat e profesorëve dhe konfirmimet formale nga dekanët e fakulteteve.		Në proces të zbatimit, ngase edhe me tutje vazhdojnë të paguhen orët mbi normë në avanc.	
	Rektori i Universitetit të Gjilanit duhet të bëj një analizë të të gjeturave të më sipërme dhe të shqyrtoj arsyet përse kërkesat e rregulloreve të brendshme për kompensim të stafit akademik nuk janë respektuar plotësisht. Rektori duhet të siguroj që kontrollet zbatohen në nivel të fakulteteve dhe orët paguhen vetëm pasi të jenë marrë siguria e nevojshme se orët janë mbajtur, përfshirë evidencat e profesorëve dhe konfirmimet formale nga dekanët e fakulteteve.			Nuk janë marrë masa.
4.4 Prokurimi në universitete	Rektori i UPz dhe ai i Gjakovës duhet të sigurojnë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha prokurimet e zhvilluara. Rrjedhimisht, duhet të vendosen kontrole të shtuara për të siguruar se dobësitë e identifikuara janë adresuar.		Në proces të zbatimit. Në Gjakovë nuk kemi identifikuar të gjetura të natyrës së tillë, derisa në Prizren ende janë vërejtur parregullsi.	

## Shtojca IV: Letërkonfirmimi



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyren Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyres Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.
- Z. Alush Istogu..... *Alush Istogu*

U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MASHT.

Data: 27 qershor 2017, Prishtinë